



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

GOVERNMENT OF KOSOVA

VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ENERGISË  
DHE MINIERAVE

MINISTRY OF ENERGY  
AND MINING

MINISTARSTVO ENERGIJE  
I RUDARSTVA

**Minutat e Takimit të Katërt të Grupit Punues për Energji**

**(Njëhere edhe Takimi i 9-të i ECCG)**

Takimi i parë i përbashkët<sup>1</sup> midis GPE dhe ECCG u mbajt ashtu siq ishte planifikuar më 28 Mars 2007 në sallën e konferencës në MEM. Emrat e pjasmarrësve janë në fund të këtyre minutave të takimit. Takimi u hap dhe u drejtua nga z. Astrit Beqa, Sekretar Permanent në MEM. Agjenda e takimit u aprovua ashtu siq është e bashkangjitur në Shtojcën 1. Minutat e takimit të 3të të GPE u aprovuan ashtu si u prezantuan.

**I. Progresi në implementimin e Planit Veprues të Partneritetit Evropian (PVPE)**

Z. Astrit Beqa bëri një prezantim të detajuar në poëer point mbi aktivitetet kryesore dhe progresin e shënuar në kuadër të PVPE-së dhe Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE). Pas prezantimit bënë diskutime dhe u dhanë komente.

Në lidhje me përatisjet për ndërtimin e linjës transmetuese interkonektuese 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, Znj. Lendita Gashi, AER, pyeti për ekzistencën e ndonjë plani të Qeverisë së Kosovës për ta financuar atë nga buxheti i vet. Z. Beqa u përgjeggj së MEM e ka propozuar një gjë të tillë në Qeveri, por vetëm nëse nuk e marrin institucionet zhvillimore ndërkombëtare, siq është KfW. Qeveria e Kosovës (QK) ka ndarë 1 milion Euro në vitin 2007 për të financuar punët përgatitore për ndërtimin e kësaj linje. KOSTT-i, në koordinim me homologun nga Shqipëria, ka ndërmarrë disa hapa dhe ka paraqitur projektin në KfW në Frankfurt. Znj. Ganimete Huruglica, Përfaqësia e KfW-së në Kosovë informoi për takimin me KOSTT-in ku KfW kërkoi nga KOSTT-i kopjen e të gjitha projekteve/studimeve ekzistuese relevante për këtë projekt. KfW ka dorëzuar kërkesat nga Shqipëria dhe KOSTT-i në BMZ (Ministria Gjermane për Bashkëpunim). Pritet një përgjigje positive së shpëjti nga Gjermania. Znj. Huruglica informoi gjithashtu se KfW ka pranuar një listë të projekteve

<sup>1</sup> Në fund të vitit 2006, është themeluar një Grup Punues për Energji (GPE) në kuadër të agjendës së Qeverisë së Kosovës për Integrim Evropian. Përgjegjësia kryesore e GPE është koordinimi dhe monitorimi i implementimit të Planit Veprues të Partneritetit Evropian (PVPE) në fushën e energjisë. GPE përfshin të gjithë partnerët kyq vendor e poashtu edhe përfaqësuesit e donatorëve ndërkombëtar që janë aktiv në sektorin energjetik të Kosovës.

Të gjitha aktivitetet kyqe që Kosova i përmbush në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) janë të integruara në PVPE. Në anën tjetër të gjithë anëtarët e ECCG janë gjithashtu anëtarë edhe të GPE. Për më tepër që të dyja ECCG dhe GPE koordinohen nga MEM-i. Për këtë arsye me propozimin e MEM-it, palët përfshirë këtu edhe AER u pajtuan që të organizojnë një takim të përbashkët ndërmjet GPE dhe ECCG në 28 Mars 2007. Është e mundur që kjo përvojë mund të vazhdojë edhe në të ardhmen.

prioritare nga Ministri Ruli nga Shqipëria, ku linja 400 kV paraqitet të jetë top prioritare.

Z. Beqa informoi se në kuadër të dy memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, ne kemi themeluar një grup të përbashkët punues për të koordinuar aktivitetet për ndërtimin e linjës transmetuese interkonektuese 400 kV. Shpresojmë që progresi të jetë së shpejti i dukshëm.

## **II. Agjenda e fundit Evropiane**

Z. Albinot Bimbashi nga Agjencioni Evropian për Integrim (AEI) lavdëroi për një pjesmarrje aq të gjërë të partnerëve në takim. Ai i informoi pjesmarrësit mbi takimin e dymbëdhjetë të Mekanizmit Shoqëruar Stabilizues (MSHS) ndërmjet BE-së dhe Kosovës të mbajtur më 19 Mars 2007. Ndërmjet takimit të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të MSHS janë ndërmarrë një numër aktivitetesh. Gjatë takimit të dymbëdhjetë të MSHS është rënë dakord të implementohet një strukturë e re për ëorkshopet sektoriale. Gjithashtu është miratuar që takimet e MSHS të mbahen çdo gjashtë muaj, dhe jo çdo tre muaj si ka qenë deri më tani. SHE kanë kërkuar që të organizohet së paku një ëorkshop sektorial çdo gjashtë muaj.

## **III. Informata mbi takimin e fundit të PHLG në Vjenë më 14 Mars 2007**

Znj. Lejla Uzicanin informoi pjesmarrësit mbi takimin e katërt të PHLG në Vjenë më 14 Mars 2007. Agjenda e këtij takimi ishte e gjatë. Progresi i implementimit të kërkesave të TKE është vlerësuar për secilën palë kontraktuese. Deri më tani Kosova ka shënuar progress ashtu siq është planifikuar. Puna prioritare përfshin përgatitjen e sigurisë së furnizimit me energji në Kosovë. Çështje tjera të rëndësishme të diskutuara gjatë takimit të fundit të PHLG përfshijnë (i) implementimin e *acquis* për burime të ripërtërshme (vetëm Kosova kish dërguar Planin e Veprimit për Burime të Ripërtërshme në afatin e caktuar), (ii) MM Social (SHE do t'i paraqes palëve të TKE një version tjetër të MM për komente përfshirë edhe afatin kohor, ku SHE do të jetë palë), (iii) Forumi i ardhshëm i Athinës të mbahet më 24-25 Prill 2007, dhe (iv) Takimi i ardhshëm i PHLG është caktuar të mbahet më 28-29 Qershor 2007 në Mal të Zi.

## **IV. Mbi themelimin e një kompanie të re të minierave**

Nuk morrën pjesë përfaqësues nga AKM ashtu siq ishte paraparë me Z. Ilir Salihu nga AKM. Kështu që nuk kishte ndonjë prezantim/informatë mbi këtë çështje. Pjesmarrësit u pajtuan që ta mbajnë këtë temë në agjendën e takimit të ardhshëm të GPE.

## **V. Raport progresi për PVPE (përmirësimi i inkasimit dhe furnizimit me energji elektrike)**

Vetëm një zyrtar nga KEK-u – Distribucioni morri pjesë në takim. Ai nuk ishte i përgatitur të japë ndonjë informacion relevant mbi këtë çështje. Kështu që nuk kishte ndonjë prezantim/informatë për këtë. Pjesmarrësit u pajtuan që ta mbajnë edhe këtë temë në agjendën e takimit të ardhshëm të GPE. Disa pjesmarrës shprehën zhgënjimin e tyre për pjesmarjen e KEK-ut në GPE. Ata kërkuar mbështetje nga Shtylla e IV dhe organizatat tjera që mund të kenë ndikim në menagjmentin e KEK-ut në mënyrë që ta marrin me seriozitet punën e pjesmarrjes në GPE.

## **VI. Raport progresi mbi përgatitjen e Strategjisë së Minierave**

Z. Kemajl Zeqiri bëri një prezantim gjithpërfshirës mbi progresin dhe statusin e Strategjisë së Minierave në Kosovë. Znj. Nezakete Hakaj nga MMPH sugjeroi që MMPH të përfshihet në përgatitjen e kësaj Strategjie në lidhje me çështjet mjedisore.

Z. Beqa shpjegoi që MEM-i është i hapur dhe do të vlerësonte shumë pjesëmarrjen e MMPH në këtë proces sa më shpejtë që të jetë e mundur. Strategjia është kontraktuar të përgatitet deri në Tetor të vitit 2007.

## **VII. Diskutime**

Kishte disa diskutime, në vijim është një përmbledhje e tyre.

Z. Daniel Schroth nga UNMIK-u përmendi shqetësimin SHE në lidhje me pavarësinë e ZRE dhe inkasimet e KEK-ut. Ai fuqimisht mbështeti nevojën që KEK-u të jetë i pranishëm në takimet e GPE, dhe se UNMIK-u do të qaset KEK-ut për këtë çështje. UNMIK-u gjithashtu i'u adresua çështjes së KOSTT-it në lidhje me kompenzimin nga homologu i Serbisë. Për më tepër ai rekomandoi që MEM-i të organizojë takimin e ardhshëm të Task Forcës së përbashkët. Një çështje tjetër që u cek nga Z. Schroth ishte 29 Marsi 2007, takimi i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut. Kështu që ai nixti përfaqësuesit e Qeverisë në këtë Bord të ngrisin çështjen e vendimit të Qeverisë mbi themelimin e një kompanie të re të linjës.

Znj. Lendita Gashi propozoi që MEM-i të kërkojë nga AKM dhe KEK-u që të dërgojnë raportin e tyre të gjithë anëtarëve të GPE për agjendën e takimit të katërt të GPE. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan me këtë propozim.

Z. Beqa informoi se çështja e KOSTT-it në lidhje me kompenzimin nga homologu i Serbisë u ngrit përgjatë takimit të 12të të MSHS më 19 Mars 2007. Ai gjithashtu kërkoi mbështetjen nga AEI për përpjekjet për të pasur KEK-un një anëtar të rëndësishëm të GPE ashtu siq do të duhej të ishte. Përfaqësuesi i AEI premtoi se do të mirrej më këtë çështje.

Z. Gezim Pula shprehi përvojën dhe shqetësimin e MEM-it për neglizhimin e bashkëpunimit ndërinstitucional nga ana e AKM-së dhe KEK-ut. Kosova ka obligime ndaj Integritimit Evropian dhe TKE, dhe kjo do të mund të rrezikohet në qoftë se organizatat si KEK-u dhe AKM nuk i përkushtohen plotësisht këtij bashkëpunimi. Bashkëpunimi është i domosdoshëm.

Z. Beqa tha se MEM-i është duke bërë të gjitha përpjekjet në mënyrë që bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informative dhe raporteve në kuadër të TKE dhe PVPE, të jetë asistues dhe të sjell rezultatet e planifikuara.

Z. Muhamet Aliu, Sekretar Permanent i MMPH shprehi shqetësimin e tij për përkushtimin e KEK-ut ndaj Integritimit Evropian në kuadër të GPE. Ne nuk duhet të pranojmë që KEK-u dhe AKM të neglizhojnë bashkëpunimin e këtij forumi. MMPH është plotësisht e mobilizuar për të vazhduar më tutje me përmbushjen e këtyre obligimeve. Ai sugjeroi që anëtarët e Qeverisë në bordet e AKM-së dhe KEK-ut të intervenojnë duke kërkuar nga menagjerët e këtyre dy organizatave të marrin pjesë në mënyrë aktive në GPE. Ai propozoi të dërgohet letër të dyje këtyre bordeve.

Znj. Resmie Ahma nga KOSTT-i informoi se KOSTT-i dëshiron të bëjë një preantim në takimin e ardhshëm të GPE

## **VIII. Agjenda për takimin e ardhshëm të GPE**

Z. Agim Zuzaku propozoi që takimi i ardhshëm i GPE të mbahet më 24 Prill 2007. Znj. Gashi dhe Znj. Uzicanin përkujtuan se më 24-25 Prill mbahet Forumi i Athinës, kështu që takimi i pestë i GPE duhet të mbahet ndonjë ditë tjetër. U ra dakord që anëtarët e GPE do të informohen me kohë për datën dhe kohën e takimit vijues.

Z. Beqa përsëriti që (raporti nga KEK-u dhe informatat nga AKM) që mbeten të pashtjelluara në këtë takim do të jenë në agjendën e takimit të ardhshëm përsëri.

Informatat nga KOSTT-i është një pikë tjetër që mund të paraqitet në agjendën e takimit të ardhshëm.

### Lista e Pjesmarrësve

<b>Nr</b>	<b>Emri</b>	<b>Organizata</b>
1	Arben Nagavci	USAID
2	Mike Thaimor	USAID
3	Agim Zuzaku	MEM
4	Kemajl Zeqiri	MEM
5	Dukagjin Shala	MEM
6	Besim Veselaj	MEM-DSZH
7	Ganimete Huruglica	KfW
8	Lendita Gashi	EAR
9	Albinot Bimbashi	AIE
10	Jeta Bejtullahu	WYG/ZKM
11	Valon Stavileci	MEM
12	Muhamet Aliu	MMPH
12	Astrit Beqa	MEM
14	Gezim Pula	MEM
15	Salvador Elmazi	MEM
16	Ian Broën	EAR
17	Daniel Schroth	UNMIK
18	Nezakete Hakaj	MMPH
19	Shpresa Kursani	KOSTT
20	Resmie Alima	KOSTT
21	Philippe Draut	OSCE
22	Avni Alidemaj	KEK- Distribution
23	Fitim Haziri	MEM
24	Vaso Leno	MEM
25	Arbene Aliu	MEM

Minutat e takimit u përgatitën nga z Agim Zuzaku dhe z Vaso Leno



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

GOVERNMENT OF KOSOVA

VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ENERGISË  
DHE MINIERAVE

MINISTRY OF ENERGY  
AND MINING

MINISTARSTVO ENERGIJE  
I RUDARSTVA

**Office of the Permanent Secretary**

**Annex1: Axxhenda**

**Takimi i Katërt i Grupi Punues për Energji**

<b>Data:</b>	<b>28.03.2007</b>	
<b>Kohëzgjatja e parashikuar:</b>	<b>10:00 – 12:00</b>	
<b>Lokacioni:</b>	<b>Ministria e Energjisë dhe Minierave – Salla e takimeve kati II</b>	
<b><u>Koha</u></b>	<b><u>Tema</u></b>	<b><u>Prezantues</u></b>
10:00	Fjala Hyrëse - Aproximi i Minutave të takimit të 3-të - Progresi i PVPE	Astrit Beqa
10:30	Axxhenda e fundit evropiane	AIE
10:40	Informacion mbi takimin e fundit të PHLG në Vjene në datën 14 mars 2007	Lejla Uzicanin
11:00	Mbi krijimin e ndërmarrjes së re të linjës	AKM
11:15	Raporti i Progresit për Prioritetet e PVPE-së (ngritja e shkallës së inkasimit dhe furnizimi me energji elektrike)	KEK
11:30	Raporti i Progresit në përgatitjen e Strategjisë së Xehetarisë	Kemajl Zeqiri
11:45	Diskutime	
12:00	Propozimi i axhendës për takimin e ardhshëm	